



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net

RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR PERIUDHËN JANAR/MARS - 2019

Prill/2019

P Ë R M B A T J A

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	6
3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike	8
4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike...9	
4.1 Paga dhe mëditje	9
4.2 Mallra dhe shërbime.....	13
4.3 Shpenzime komunale.....	16
4.4 Subvencione dhe transfere.....	16
4.5 Investime kapitale.....	17
5. Të hyrat vetanake.....	18
6. Të hyrat nga donacioni.....	19

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit, neni 180 lidhur me procedurat buxhetore, rektori i Universitetit të Mitrovicës paraqet për aprovim raportin mbi planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-mars të vitit fiskal 2019.

Buxhetin e Universitetit të Mitrovicës e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i të gjitha kërkesave të administratës qendrore dhe njësive akademike të harmonizuara me planin e rrjedhës së parasë për vitin fiskal 2019.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019/2021, vendimeve nga niveli qendror(MF,MASHT), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit.

Periudha raportuese për Universitetin e Mitrovicës, karakterizohet si sfiduese me faktin se janë planifikuar ose do të jenë në finalizim shumë aktivitete të cilat ndërlidhen me mjete financiare dhe kufijtë e përcaktuar buxhetor për të gjitha kategoritë ekonomike. Rezultatet e planifikuara në masë të madhe do të varen nga qasja e realizimit të kërkesave të njësive akademike,administratës dhe vendimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit të UMIB-it.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore dhe vendimin mbi ndryshimin e buxhetit për vitin 2019, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.
4. Vendimi i MF për harmonizim të shpenzimeve kapitale
5. Statuti i përkohshëm për UMIB.
6. Buxheti për vitin 2019 për UMIB
7. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2019


Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

Buxhetit për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr.06-L-133

Buxheti për UMIB i aprovuar në shkurt/2019 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.06/L-133 është 4.788.969.00 euro që në krahasim me buxhetin final të vitit 2018 është më i lartë për 1.634.222.95 euro ose me indeks prej 51.80% .

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2019
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.757.430.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00
4.	SUBVENCIONE	100.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	850.000.00
6.	GJITHSEJ	4.788.969.00



Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2019	Burimet e financimit	
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.757.430.00	2.642.769.00	114.661.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00	866.339.00	
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	215.200.00	
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00	
5.	INVESTIME KAPITALE	850.000.00	850.000.00	
6.	GJITHSEJ	4.788.969.00	4.674.308.00	114.661.00


Paga dhe mëditje- për vitin fiskal 2019 masa buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.757.430.00 euro që është për 380.542.25 euro më e lartë se paga finale për vitin fiskal 2018. Indeksi i rritjes është për 16.01% kurse pjesëmarrja e buxhetit për paga dhe mëditje në strukturë është 57.57% të buxhetit të aprovuar.

Mallra dhe shërbime - Masa buxhetore për këtë kategori është 866.339.00 dhe është më e lartë për 495.060.00 ose me indeks të rritjes 133.30% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018.

Shpenzime Komunale- shpenzimet komunale janë 215.200.00 dhe janë më të larta për 55.000.00 euro ose me indeks prej 34.33%% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018

Subvencionet- mjetet e planifikuara janë në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë më të larta për 70.000.00 euro ose me indeks prej 233.33% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018.

Investime kapitale- Investimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar me shumë prej 850.000.00 dhe janë më të larta për 633.681. euro ose me indeks prej 292.93 00292.93



2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve publike.

Buxheti për UMIB-in i aprovuar në Shkurt/2019 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.06/L-133 është 4.788.969.00 që në krahasim me buxhetin final të vitit 2018 është më i lartë për 1.634.222.95 euro ose me indeks prej 51.80% .

Për periudhën raportuese (janar-qershor) janë alokuar mjete në shumë prej 2.964.590.57 euro ose 63.42% të buxhetit të aprovuar. Alokimi i mjeteve është bërë sipas planit të rrjedhës së parasë të hartuar sipas strukturimit të kërkesave dhe planifikimit të aktiviteteve për administratën qendrore dhe të njësive akademike.

Realizmi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 52.86% (1.567.019.58) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 32.72% në krahasim me buxhetin e aprovuar. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 2.482.880.45 euro ose 83.75% të mjeteve të alokuara.

Periudhën janar/qershor mund të karakterizohet si sfiduese me faktin se aktivitetet janë përqendruar në funksionalizimin e kampusit të ri universitar. Masa buxhetore e planifikuar për në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime është orientuar në shpenzimet e planifikuara por edhe ato jo të planifikuara në funksionalizim të objekteve, laboratorëve dhe sallave të leximit dhe bibliotekës .

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë.

Periudha janar/qershor për shkak të specifikave në aspektin buxhetor dhe financiar karakterizohet mjaft sfiduese për faktin:

1. Vonesa në aprovimin e buxhetit,
2. Ndryshimeve dhe alokimit me vonesë të mjeteve për periudhën raportuese.
3. Realizimi i shpenzimeve të kushtëzuara nga afatet e stërzgjatura të Ligjit të prokurimit.

Kuvendi i Kosovës me propozim të Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës aprovoj kërkesat për buxhet shtesë për UMIB. Kërkesat ishin të arsyeshme me ç'rast universitetit iu mundësua që të realizon objektivat dhe aktivitetet e planifikuara në të gjitha kategoritë ekonomike.

Aprovimi me vonesë i buxhetit dhe alokimit, ndikoi që në kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime, subvencione dhe investime kapitale mos të arrihen objektivat e planifikuara. Për periudhën raportuese në kategorinë mallra dhe shërbime është planifikuar që të bëhet funksionalizimi dhe pajisja e bibliotekës me inventar dhe teknologji informative .Mjetet janë alokuar mirëpo për shkak të afateve të tej zgjatura të prokurimit, realizimi i disa projekteve është për korik dhe gusht. Investimet kapitale kanë po të njëjtat vështirësi të realizimit edhe pse

mjetet janë alokuar, zotuar dhe kemi filluar me procedurat e ofertimit. Planifikohet që projektet të realizohen deri në fund të gushtit.

Vështirësitë e lartë shënuara përkundër angazhimeve ndikuan që indeksi i realizimit të jetë vetëm 52.86% në krahasim me mjetet e alokuara. Indeksi i realizimit është më i ulët për 26.86% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018 (57.37%).

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese janar/mars 2019.

Buxheti i planifikuar i bazuar në Ligjin mbi buxhetin për 2019	Alokimi Janar/Mars/2019	Mjetet e shpenzuara Janar/Mars 2019	Indeksi i realizimit në raport me Ligjin e aprovuar mbi buxhetin 2019	Indeksi i realizimit në raport me alokimin e mjeteve
1	2	3	4=3/1*100	5=3/2*100
4.788.969.00	2.107.103.00	642.887.49	13.42	30.51


3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyrojnë: si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

Për periudhën raportuese (janar-mars) janë alokuar mjete në shumë prej 2.107.103.00 euro ose 43.99 % të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit është me indeks prej 30.51 % (642.887.49 euro) bazuar në alokimin e mjeteve.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokime, zotime, realizim dhe indeks të realizimit

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2019	Alokimi Janar/qershor	Mjetet e shpenzuara Janar/qershor	Zotimet/obligimet e pa shlyera	Shpenzimet e planifikuara	Mjetet e pashfrytëzuara	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
	1	2	3	4	5=3+4	6=2-5	7=5/2*100	8=3/2*100
Paga & Mëditje	2.757.430.00	1.228.522.14	1.228.522.14		1.228.522.14		100	100
Mallra&Shërbime	866.339.00	700.792.43	118.180.13	163.349.87	281.530.00	419.262.43	40	17
Shpenzime komunale	215.200.00	85.276.00	67.828.31		67.828.31	17.477.69	80	80
Subvencione	100.000.00	100.000.00	55.000.00		55.000.00	45.000.00	55	55
Kapitalet	850.000.00	850.000.00	97.489.00	752.511.00	850.000.00		100	11
Total	4.788.969.00	2.964.590.57	1.567.019.58	915.860.87	2.482.880.45	1.418.908.57	83.75	52.8



Pagat dhe mëditjet - janë alokuar 572.427.31 euro për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 572.427.31 euro ose me indeks të realizimit prej 100% përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 20.75% të mjeteve të planifikuara (2.757.430.00 euro) sipas buxhetit të aprovuar.

Mallrat dhe shërbimet janë alokuar 561.334.86 euro ose me indeks prej 64.79% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar. Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 32.305.40 euro ose me indeks prej 5.75 % në krahasim me mjetet e alokuara.

Shpenzimet komunale janë alokuar 48.341.00 dhe janë realizuar 38.154.78 ose me indeks prej 78.92% në krahasim me mjetet e alokuara

Subvencionet dhe transferet –janë alokuar 75.000.00 euro dhe mjete planifikohen te realizohen për muajin maj/2019

Investimet kapitale -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 850.000.00 mjetet për investime kapitale, planifikohet që investimet të realizohen deri në fund të qershorit/2019.

4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është 2.757.430.00 euro i planifikuar për përmbushjen e obligimeve ndaj 196 punëtorëve (129 personel akademik dhe 67 personel administrativ) dhe 3 anëtar të KD të

UMIB-it . Bazuar në strukturën organizative,numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, masa e planifikuar buxhetore mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Buxheti i planifikuar dhe realizimi i pagave për vitin 2019 ,ishin një ndër çështjet të klasifikuara me prioritet të lartë. Këshilli Drejtues përmes Rektorit duke pasqyruar gjendjen e vështirë financiare të bazuar në projekt/Ligjin mbi buxhetin përmes kërkesës(drejtuar MASHT dhe MF) për buxhet shtesë pasqyroi gjendjen e vështirë financiare dhe mungesën e buxhetit për këtë kategori. Rektori parashtrroi kërkesën edhe në Komisionin Parlamentar të Kuvendit të Kosovës,kërkesë e cila u karakterizua si e arsyeshme. Me propozim të komisionit, Kuvendi aprovoi kërkesën shtesë duke ngritë buxhetin për paga në shumë prej 510.071.00 në krahasim me projekt/buxhetin e propozuar për vitin 2019(2.247.359.00 euro)

Universiteti i Mitrovicës ka hartuar planin e personelit për vitin 2019 për administratë dhe personel akademik i cili është i bazuar në strukturën organizative të aprovuar,numrin aktual dhe numrin e vendeve të lira. Plani nënkupton edhe disponueshmërinë e mjeteve për të mbuluar obligimet ndaj personelit aktual dhe plotësimin e vendeve të lira.

Bazuar në numri e lejuar dhe buxhetin e aprovuar për paga dhe mëditje planifikohet që gjatë vitit fiskal të mbulohen të gjitha vendet e lira për personel akademik dhe administrativ.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar numri i planifikuar,aktual dhe vendet e lira duke bërë ndërlidhjen e mjeteve të planifikuara për mbulimin e të gjitha pozitave të strukturuar në planin e personelit të UMIB-it.

Pasqyrë lidhur me numrin e personelit të UMIB-it dhe pasqyrimi i vendeve të lira për vitin fiskal 2019

Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje-Universiteti i Mitrovicës/numri i personelit										
nr	MASHT	Nr. i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen buxhetore për UMIB viti 2019	Numri aktual të punësuarve paga e marsit//2019 personeli akademik i rregullt	Numri aktual i të punësuarve paga e marsit/2019 personeli akademik i angazhuar	Numri aktual i të punësuarve ne administr. marsit/2019	Numri aktual i të punësuarve paga e marsit/2019 personeli akademik i i rregullt,i angazhuar dhe p.administrativ	Vendet e lira ne krahasim me numrin e lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2019	Kërkesë për plotësimin e vendeve te punës/personel akademik	Kërkesë për plotësimin e vendeve të punës përmes konkursit /personel administrativ	Tejkalim te numrit te lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2019
1	2	3	4	5	6	7=4+5+6	8=3-7	9	10	11
979	UMIB	196	102	45/18	49	169	27	9	18	-
979	An. KD	3								
	totali	199	102	18	49	169	27	9	18	-

Pasqyrë lidhur me numrin e planifikuar për anëtar të Këshillit Drejtues

Numri i lejuar sipas Ligjit mbi buxhetin për anëtar të Këshillit Drejtues					
kodi	MASHT	Numri i lejuar sipas vendimit të Ministrit të Arsimit,Shkencës dhe Teknologjisë	Mbulueshmëria e numri të lejuar nga Ligji mbi ndarjen buxhetore për anëtar të deleguar nga Ministri	Mbulueshmëria e numri të lejuar nga Ligji mbi ndarjen buxhetore për anëtar të përzgjedhur nga UMIB	Numri qe duhet mbulohet nga Planifikimi i numrit dhe pagave për personelin e UMIB-it anëtar i deleguar /ndërhyrje në buxhetin e planifikuar për personelin e UMIB-it
1	2	3	4	5	6=3-(4+5)
979	An. KD	9	3	5	1
	totali	9	3	5	1

Me rekomandim të Ministrisë së Financave(bazuar në rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit të Kosovës), përgjegjësit e MASHT-it obliguan nënprogramet e tyre (universitetet publike) që të gjitha obligimet ndaj anëtarëve të Këshillave Drejtues të realizohen nga kategoria paga dhe mëditje. Buxheti i planifikuar për të mbuluar pagat dhe mëditjet për anëtarët e KD është 26.184.00 euro. Implementimi i rekomandimeve të ZKA nga ana e menaxhmentit është

karakterizuar si ndërhyrje në buxhetin e planifikuar për paga dhe mëditje me faktin se deri në vitin 2018 të gjitha obligimet janë mbuluar nga kategoria mallra dhe shërbime. Për këtë qëllim, rektori parashtron kërkesë për buxhet shtesë, kërkesë e cila është realizuar pjesërisht duke akorduar shumë prej 23.352.00 euro. Ndryshimi në shumë prej 2.832.00 euro duhet plotësuar nga buxheti i planifikuar për personelit akademik ose administrativ.

MF dhe MASHT, në respektim të rekomandimeve në Ligjin mbi ndarjen buxhetore ngritën numri e lejuar te personelit të UMIB-it për 3, duke konsideruar se numri i lejuar është për anëtarë të KD.

Pasqyrë e planifikimit të buxhetit për KD i bazuar në numri e lejuar sipas vendimit të Ministrisë të MASHT.

Numri i lejuar sipas Ligjit mbi buxhetin për anëtar të Këshillit Drejtues					
kodi	MASHT	Numri i lejuar sipas vendimit të Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Buxheti i lejuar për realizim të obligimeve për anëtar të KD për vitin 2019	Buxheti i lejuar sipas rekomandimeve të MF, MASHT dhe ZKA	Ndërhyrja/implikimi në buxhetin e planifikuar për personelit të UMIB-it
1	2	3	4	5	6=5-4
979	Kryesues i KD	1	3.528.00	3.528.00	
979	Anëtar i KD	8	22.656.00	19.824.00	2.832.00
	totali	9	26.184.00	23.352.00	2.832.00

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehet se, jo vetëm që kemi ndërhyrja në masën buxhetore të planifikuar për paga dhe mëditje për personelit të UMIB-it, por kemi edhe ndërhyrja në numrin e lejuar të personelit. Numri i planifikuar për personelit do të zvogëlohet për 1 të punësuar (196-1=195 ose sipas strukturës 128 personelit akademik dhe 67 personelit administrativ).

Për shkak të procedurave administrative paga e planifikuar për anëtar të KD të deleguar nga MASHT për periudhën raportuese nuk janë realizuar. Planifikohet që në koordinim me Thesarit të definohet mënyra e pagesës për anëtar të cilët kanë burime të financimit nga Buxheti i Kosovës (pagë primar dhe sekondare).

Buxheti i planifikuar për mbulimin e të gjitha pozitave të pasqyruar në planin e personelit dhe anëtar të Këshillit Drejtues të UMIB-it për vitin 2019

Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje-Universiteti i Mitrovicës/buxheti/ personelit akademik dhe administrativ/implikimet										
nr	MASHT	Nr. i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen buxhetore për UMIB viti 2019	Numri i personelit të UMIB-it bazuar në pagën e prillit	Buxheti i planifikuar për vitin fiskal 2019	Buxheti i planifikuar për 4 anëtar të deleguar të KD	Buxheti i planifikuar për personelin akademik aktual dhe i angazhuar gjithsej 119(102+17)	Buxheti sipas kërkesës për plotësim të vendeve/avancim dhe përmes konkursit gjithsej 9 personelit akademik	Buxheti i planifikuar për personelin administrativ aktual gjithsej 49	Buxheti sipas kërkesës për plotësim të vendeve/pozitave të lira në administratë/plani i personelit gjithsej 18 pozita	Implikimi buxhetor
1	2	3	4	5	6	6	7	8	9	10=5-(6+7+8+9)
979	UMIB	195	169	2.745.406.00	12.024.00	2.092.676.20	115.002.34	402.498.72	135.228.74	-
979	An. të delegua të KD	4	4	12.024.00						
	totali	199	173	2.757.430.00	12.024.00	2.092.676.20	115.002.34	402.498.72	135.228.74	-

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave për periudhën janar/mars në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2019	Alokimi e mjeteve për paga për periudhën Janar-Mars/2019	Pagat e realizuara për periudhën Janar-Mars/2019	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar-Mars/2019
		2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.757.430.00	572.427.31	572.427.31	100


Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese është planifikuar (sipas rregullave të MF 1/12 e pagës totale) shuma prej 689.357.49 euro janë alokuar 572.427.31 euro kurse janë shpenzuar 572.427.31 euro. Mjetet janë realizuar me indeks prej 100% në krahasim me mjetet e alokuara. Bazuar në metodologjinë e aplikuar nga MF,UMIB-i për këtë periudhë ka suficit për 116.930.18 euro. Mbetja do të shpërndahet varësisht nga nevoja për të plotësuar numri e pozitive të lira për vitin fiskal 2019.

Nr	Planifikimi I pagave për periudhën janar/mars të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2019	Alokimi I mjeteve për periudhën janar/mars	Realizimi I pagave për periudhën janar/mars	Mbetja e buxhetit për periudhën janar/mars
	1	2	3	4=3-1
1	689.357.49	572.427.31	572.427.31	116.930.18

Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UMIB

n r	UMIB	Person. Administ	shuma	Personel akadem.	shuma	Personel . angazh.	shuma	Tot ali	Shuma
1	JANAR	49	30.350.98	97	145.238.21	52	6.838.61	198	182.427.80
2	SHKURT	49	30.254.86	101	146.462.90	49	14.115.15	198	190.832.90
3	MARS	49	32.630.68	102	166.164.93	49	371.00	199	199.166.61
4	Gjithsej		93.236.52		457.866.04		21.324.76		572.427.31

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 457.866.04 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 79.98% të shumës së shpërndarë(572.429.35),për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 21.324.76 euro ose 3.72% dhe për personelin administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 93.236.52 euro ose 16.28% të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



4.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për periudhën janar/mars bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 561.334.86 euro, janë realizuar 32.305.40 euro dhe mjete të zotura(angazhuara) në shumë prej 44.465.32 euro. Për periudhën raportuese janë angazhuar 76.770.72 ose me indeks të angazhimit prej 13.67 % më krahasim me mjetet e alokuara.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve buxhetit sipas	Alokimi i mjeteve-janar/mars	Mjetet e shpenzuara-janar/mars	Mjetet e zotura-janar/mars	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00	561.334.86	32.305.40	44.465.32	5.75

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

KODI EKONOMIK	KATEGORIA EKONOMIKE	BUXHETI PËR VITIN 2019	ALOKIMI 1-3/2019	MJETET E SHPENZUARA 1-3/2019
		1	2	3
013000	Mallrat dhe shërbimet	866,339.00	561,335.00	32,305.40
013100	Shpenzimet e udhëtimit	5,000.00	5,000.00	1,613.89

013130	Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit			
013140	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit			329.69
013142	Akomodimi gjate udhetimit zyrtar jasht vendit			
013300	Shërbimet e telekomunikimit	28,343.42	7,225.28	5,756.88
013310	Shpenzimet per Internet	5,024.56	624.99	
013320	Shpenzime tjera telefonike - Vala 900	21,800.42	5,400.00	5,756.88
013330	Shenzimet postare	518.44	200.29	
013340	Shpenzimet për përdorim të kabllit optik	1000.00	1,000.00	
013400	Shpenzimet për shërbimet	55,459.09	55,459.09	9,910.19
013410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4,459.09	4,459.09	1,160.00
013440	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës			
013430	Shërbime të ndryshme shëndetësore			
013440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse			
013450	Sherbime shtypje-jo marketing	20,000.00	20,000.00	787.00
013460	Sherbime tjera kontraktuese	30,000.00	30,000.00	7,963.19
013470	Sherbimet teknike	1,000.00	1,000.00	
013480	Shpenzimet për anëtarësim			
013495	Pagesa për Vendime Gjyqësore			
013500	Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	539,664.76	413,690.93	
013501	Mobilje	332,000.00	332,000.00	
013502	Telefona	23,000.00	23,000.00	
013503	Kompjuterë	105,840.15	54,690.93	
013504	Harduer për teknologji informative			
013505	Makina fotokopjuese			
013506	Pajisje speciale mjekësore			
013507	Pajisje të shërbimit policor			
013508	Pajisje trafiku			
013509	Pajisje tjera	78,824.61	4,000.00	
013600	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	16,827.26	7,913.96	
013610	Furnizime për zyrë	11,327.26	3,413.96	
013620	Furnizim me ushqim dhe pije(spitale, burgje, cerdhe- jo dreka zyrtare)	2,000.00	1,000.00	
013630	Furnizime mjekësore (organizata shëndetësore,qendrat e mjekësisë familjare)			
013640	Furnizime pastrimi	500.00	500.00	
013650	Furnizim me veshmbathje			
013655	Furnizim me preparate kimike	2,000.00		
013660	Akomodimi (Strehimi I punëtorëve)	1,000.00		

013670	Municion dhe armë zjarri			
013681	Bllombat			
013700	Derivatet dhe lëndët djegëse	5,688.44	2,915.86	
013710	Vaj			
013720	Naftë për ngrohje qendrore	1,500.00	1,500.00	
013730	Vaj për ngrohje			
013740	Mazut			
013750	Qymyr			
013760	Dru			
013770	Derivate për gjenerator			
013780	Karburant për vetura	4,188.44	1,415.86	
013800	Llogarite e avansit	9,324.61	8,000.00	
013810	Avans per para te imeta(p.cash)	2,000.00	2,000.00	
013820	Avans per udhetime zyrtare	7,324.61	6,000.00	
01395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	63,600.00	18,163.62	8,015.40
013950	Regjistrimi i automjeteve			
013951	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	3,000.00	1,500.00	
013952	Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve	600.00	300.00	
013953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	60,000.00	16,363.62	8,015.40
014000	Mirëmbajtja	129,431.42	34,966.26	7,830.54
014010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	1,500.00	
014020	Mirëmbajtja e ndërtesave	80,363.63	23,090.89	5,000.54
014040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	10,000.00	3,000.00	
014050	Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve	1,000.00	1,000.00	
014200	Shpenzimet e marketingut	12,000.00	12,000.00	1,972.00
014210	Reklamata dhe konkurset	2,000.00	2,000.00	992.00
014220	Botimet e publikimeve	5,000.00	5,000.00	
014230	Shpenzimet per informim publik	5,000.00	5,000.00	980.00
014300	Shpenzimet e përfaqësimit	6,000.00	3,000.00	1,133.50
014310	Drekat zyrtare	6,000.00	3,000.00	1,133.50
014400	Shpenzime për vendime të gjykatave	500.00	500.00	
014410	Shpenzime për vendime të gjykatave	500.00	500.00	

Inaugurimi i kampusit të ri universitar bëri që menaxhmenti përmes KD të aktualizoj gjendjen jo të mirë të buxhetit për këtë kategori ekonomike. Kuvendi i Kosovës përmes kërkesës së Komisionit Parlamentar aprovoi buxhet shtesë në shumë prej 500.000.00 për të funksionalizuar kampusin e ri universitar.

Akordimi i buxhetit shtesë dhe nevoja për të ofruar kushte dhe standard të lartë të studimeve, shtyri që menaxhmenti të përcaktojë prioritetet dhe dinamikën e realizimit të mjeteve për këtë kategori. Prioritet ju është dhënë funksionalizimit dhe pajisjes së sallës së leximit me inventar dhe pajisje të teknologjisë informative. Aktivitetet e planifikuara janë inkorporuar në planin e rrjedhës së parasë duke koncentruar shumën prej 561.335.00 euro për tre mujorin e parë të vitit 2019. Mjetet e planifikuara janë me indeks prej 64.79 të buxhetit të aprovuar për vitin 2019 (866.339.00 euro).

Indeksi i realizimit prej 5.75% është i arsyeshëm me faktin se furnizimi dhe pajisja e bibliotekës me inventar dhe kompjuter për shkak të procedurave të Ligjit të prokurimit kërkon kohë. Planifikohej që projekti për bibliotekë të finalizohet deri në qershor 2019.

Periudha prill/qershor do të jetë sfiduese me faktin se planifikohej të finalizohen shumë aktivitete të cilat arsyetojnë edhe angazhimin e mjeteve me indeks prej 64.79% të mjeteve të planifikuara për këtë kategori ekonomike. Prioritetet janë përcaktuar nga përgjegjësitë e njësive akademike dhe zyrave të administratës qendrore/rektorat.

4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Për këtë kategori janë alokuar mjete në shumë prej 48.341.00 euro duke shpenzuar 38.154.14 euro ose 78.92% të shumës së alokuar. Plani i rrjedhës së parasë për shpenzime komunale është i bazuar në shpenzimet e realizuar për periudhën tetor/nëntor të vitit 2019.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	48.341.00	38.154.78	78.92

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Nr	Përshkrimi	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2018	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5	6=5/4*100
1.	E.elektrike	94,000.00	16,000.00	11,211.37	70.07
2.	H. e ujit	14.499.00	2,400.00		
3.	Mbeturina	9,172.66	2.499.33	464.00	18.56
4.	PTK	2,500.00	624.00	319.41	51.18
5.	Ngrohja qendrore	95,028.34	26,817.67	26,160.00	97.54
6	Totali	215,200.00	48,341.00	38,154.78	78.92

4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 100.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, si dhe stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa të ndara nga UMIB-i.

Bazuar në planifikim, Këshilli Drejtues sjellë vendim që të shpallet konkursi për stimulimin e studentëve të dalluar. Shuma e bursave do të përcaktohet varësisht nga numri i studentëve të cilët i plotësojnë kriteret e definuar.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Zotimi i mjeteve	Realizimi për janar/mars/2019
		1	2	3	4
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100.000.00	75.000.00		

Alokimi i mjeteve për këtë periudhë është bërë me vonesë, për këtë shkak nuk ishim në mundësi që të bëjmë me kohë zotimin e mjeteve.

KD bazuar në kompetencat sjell vendim mbi ndarjen e bursave për student. Komisioni i përcaktuar nga KD sipas kriterëve të përcaktuara përzgjedhi student të cilët plotësojnë kriteret. Lartësi e bursës për student për vitin akademik 2018/2019 është në shumë prej 1.000.00. Përfitues të bursave janë 55 student të cilët kanë plotësuar kriteret e përcaktuara sipas vendimit.

Zotimi i mjeteve është bërë në fillim të prillit në shumë prej 55.000.00 euro kurse realizimi i bursave do të finalizohet në fund të muajit prill.

Mbetja e mjeteve prej 45.000.00 eurove duhet të realizohen sipas propozim vendimeve të menaxhmentit dhe KD. Menaxhmenti përmes KD duhet të krijoj infrastrukturës ligjore/rregullore për subvencione për realizimin e mjeteve të planifikuara/mbetura .

4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 850.000.00 euro që në krahasim me vitin 2018 masa buxhetore është rritur për 548.500.00 ose me indeks prej 181.92% . Mjete e planifikuara në shumë prej 850.000.00 euro është ndarë për pajisjen e laboratorëve të njësive akademike, pajisje me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve të ndërtuara.

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	100.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	260.000.00
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	430.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	30.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00
6.	Gjithsej /2019		850.000.00

Për periudhën raportuese mjetet e planifikuara janë alokuar dhe janë në proces të përgatitjes për ofertim. Planifikohej që realizimi i projekteve të finalizohen në qershor/korik për shkak të procedurave të zgjatura për ofertimeve për shkak të kostos së madhe të projekteve.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar gjendja e realizimit të investimeve të planifikuara kapitale.

Pasqyrë e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën janar/mars/2018

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Zotimi i mjeteve	Realizimi për janar/mars/2019
1.		1	2	3	4
	Investime kapitale	850.000.00	850.000.00		

5. T Ë HYRAT VETANAKE

Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar 45.035.00 euro (niveli Bachelor dhe Master) dhe janë të dedikuar vetëm për mbulimin e obligimeve për kategorinë paga dhe mëditje.

Indeksi i realizimit të grumbullimit të hyrave nga shërbimet e ofruara është 39.27% në krahasim me mjetet e planifikuara prej 114.661.00 euro.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara, inkasimi, alokimi, dhe shpenzimet.

	Planifikimi sipas Ligjit mbi Buxhetin për 2019	Të hyrat e bartuara nga viti fiskal 2018	Inkasimi i THV për janar/mars	Indeksi i realizimit
	1	2	3	5=3:1*100
1	114.661.00	49.510.50	45.035.00	39.27

Realizimi i inkasimit të të hyrave vetanake në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2018 është më i lartë për 4.381.50 ose me indeks prej 10.77%. Nga të hyrat e realizuar është planifikuar që të bëhet shpenzimi për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

Për këtë periudhën mjete e alokuara janë në shumë prej 2.135.50 euro nga të cilat nuk kemi mjete të shpenzuara. Planifikohet që në fund të vitit fiskal të bëhet shpenzimi i të hyrave vetanake të grumbulluara gjatë 2019

Të Hyrat e realizuara të strukturuar sipas njësive akademike

Nr	Përshkrimi i të hyrave-pagesave	F A K U L T E T I / N J Ë S I A A K A D E M I K E						TOTALI
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	
1	Për certifikatë të notave dhe diplomës	137.50	65.00	90.00	80.00	52.50	87.50	512.50
2	Për diplomë dhe mbrojtje të diplomës	80.00	30.00	60.00	15.00		45.00	230.00
	Për mbrojtje të diplomës/master	300.00	200.00	600.00				1.100.00
3	Për paraqitje të provimeve/master	157.50	577.50	365.00				1.100.00
4.	Për provim pranues për regjistrim për studime master							
5.	Për provim pranues/plotësues							
6.	Për provim në rast të transferit	32.50	12.50	8.50	27.50		11.50	92.50
7.	Për semestër për studentë të rregullt	7.025.00	4.800.00	1.750.00	8.750.00	5.125.00	2.700.00	30.150.00
8.	Për semestër për studime master	300.00	8.250.00	3.300.00				11.850.00
9.	Gjithsej	8.032.50	13.935.00	6.173.50	8.872.50	5.177.50	2.844.00	45.035.00

7. TË HYRAT NGA DONACIONI

Për këtë vit fiskal UMIB-i është përfitues i projektit ERASMUS + në shumë 25.822.00 euro, projekt që duhet implementuar për 1.5 vite. Projekti është dizajnuar për ngritjen e kapaciteteve të mësimitdhënës "Metoda Inovative për mësimitdhënie të matematikës".

Për periudhën janar/mars janë realizuar shpenzime në shumë prej 1.500.00 euro. Raporti për shpenzimet e realizuara është strukturuar sipas aktiviteteve dhe dinamikës së planifikuar për realizim të projektit.